

Kërkoj punë apo dua të ushtroj një profesion?

Larës i pjatave dhe pastaj drejtor i hotelit? Mbushëse e sirtarëve dhe pastaj udhëheqëse e supermarketit?

Karriera profesionale të këtij lloji janë të mundshme edhe në Zvicër, mirëpo shumë të rralla. Për këtë arsye më së miri është arsimimi, tregojnë vajzat e reja dhe djemtë e rinj, të cilët nuk jetojnë gjatë kohë në Zvicër. Ata të gjithë i kanë arsyet e tyre, pse kanë vendosur të arsimohen:

« Nëse jeton në Zvicër dhe nuk ke arsimim, atëherë profesionalisht ngec në vend. Gjatë tërë jetës e bën të njëjtën punë. Por unë kam dashur një punë të mirë, përgjegjësi në punë, karrierë profesionale.»

Khyber Ahmadzy

«Dua të integrohem në Zvicër, sa më shpejt të jetë e mundur, privatisht dhe profesionalisht. Për këtë arsye me anë të një praktike jam duke u përgatitur qëllimshëm për mësimin e një profesioni.»

Ruth Girmay

«Rrogën time e fitoj me punë ndihmëse. Në të vërtetë do të më interesonin shumë gjëra, por nuk kisha kohë të parashtroja pyetje. Duhej të punoja shpejt dhe në mënyrë efektive. Si fuqi ndihmëse, pa shkollim, kam fituar pak dhe mbetësha pa punë kur ndërmarrja nuk kishte mjaft porosi. Kjo më ka ndodhur dy herë.»

Luis Neto

«Për mua, si grua myslimane, është shumë me rëndësi të tregoj se jam duke punuar dhe se fitoj vetë paratë time.»

Gul Afroz Haidari

«Kam zgjedhur një profesion, në të cilin kam mundur t'i shfrytëzoj njohuritë e mia paraprake. Tash punoj një vit që të fitoj para. Pastaj dua të studioj në shkollë të lartë universitare.»

Preethy Vadakkadath

«Babi im më ka motivuar për mësim. Ai ka ardhur në Zvicër në fillim të viteve të 60-ta dhe ka punuar si punëtor ndihmës. Ai gjithmonë ka thënë: Bëje më mirë se unë, mos puno gjithmonë për të tjerët.»

Marius Pinsini

«Pas mësimit të profesionit kam njohuri profesionale, e kjo më jep siguri për kërkim të punës. Mund të fitoj para, të jetoj i pavarur. Dhe mund të mbaj kokën lart. Sepse kam arritur diçka. Shkollimi profesional është bazë për jetën time.»

Farhan Abdi Omar

Doni t'i njihni më mirë këta burra të ri dhe gra të reja? Doni të kuptoni se pse këta patjetër duan të arsimohen? Në doracakun «Çka pas shkollës?» i gjeni portretet e tyre.

Të angazhohesh disa vjet – të ndiesh ndikimin tërë jetën

«Pse duhet të njoh gjuhën mirë, nëse dua të bëj zanatin në tregti me pakicë? Në arkat e supermarketit takoj shpesh njerëz të cilët nuk e njohin mirë gjuhën.»

Ose: «Pse të mësoj matematikë – nuk do të më nevojitet më kurrë në jetë.»

Ose: «Gjatë mësimit të profesionit fitoj pak ose aspak para.»

Për arsimimin bazë, shumica investojnë dy, tri ose më shumë vjet. Ata duan të mësojnë një profesion, nuk duan vetëm të punojnë punë të thjeshta, ose punë ndihmëse.

Vendimi për t'u arsimuar, ndikon gjatë gjithë jetës profesionale. Çka është me rëndësi për ju? Si vendosni ju?

Së pari do të arsimohem

- Unë e zotëroj gjuhën dhe kam një shkollim të mirë të përgjithshëm.
- Unë nuk e bëj çdo ditë të njëjtën punë, kam shumë ndryshime.
- Unë mund të bashkëveproj në ekip, madje edhe të bashkëvendos.
- Unë bart përgjegjësi.
- Eprorët e mi kanë shumë besim në mua.
- Eprorët e mi e vlerësojnë, kur unë angazhohem.
- Punën time unë shpesh mund ta bëj në mënyrë të pavarur.
- Unë kam një pagë të mirë.
- Edhe nëse punoj me orar të pjesshëm, fitoj mjaft për një jetë të mirë.
- Unë mund ta ndryshoj vendin e punës, kur dëshiroj të mësoj diçka të re.
- Unë mund të planifikoj karrierën time dhe ta jetësoj hap pas hapi.
- Unë mund të ngrihem më tej.
- Nëse dua, kam mundësi të bëj krejt diçka tjetër, mund të ndryshoj fushën profesionale. Mund të filloj një arsimim të ri.

Punoj pa arsimim

- Unë fitoj shpejtë para.
- Çdo ditë bëj të njëjtën gjë.
- Puna ime është e thjeshtë. E kam mësuar shpejt.
- Puna ime është fizikisht më rëndë se e kolegëve të cilët kanë mësuar profesionin.
- Unë shumë rrallë kam ngritje të pagës.
- Edhe nëse e ndryshoj vendin e punës, rroga ime nuk rritet.
- Edhe nëse e ndryshoj vendin e punës, nuk më jepen punë interesante.
- Të gjithë të tjerët mund të më thonë çka duhet të bëj.
- Shpesh mërzitem në punë.
- Unë nuk mund të ngrihem më tej, sepse nuk kam arsimim bazë.
- Kur ndërmarrja ka pak porosi, unë largohem më shpejt nga puna, sesa kolegët e mi të arsimuar.
- Kur jam i papunë, e kam më vështirë të gjej një punë të re. Nuk ka shumë vende pune për njerëz të pakualifikuar.